



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
ENERGY REGULATORY OFFICE
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Përcaktimi i parametrave kyç rregullator

Prishtina, 6 shkurt 2012

Përmbajtja

| | | |
|----------|---|----------|
| 1 | Hyrje | 1 |
| 2 | Vlerat indikative | 1 |
| 2.1 | Vlera indikative për Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit | 1 |
| 2.2 | Vlerat indikative për reduktimin e humbjeve | 1 |
| 3 | Komentet e Këshilltarëve të Transakcionit | 2 |
| 4 | Përcaktimi i vlerave përfundimtare | 2 |

1 Hyrje

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) është në procesin e vendosjes së parametrave kyç rregullator që përdoren për llogaritjen e Të Hyrave të Lejuara dhe Tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes dhe Furnizuesit Publik të Energjisë Elektrike.

Më 29 dhjetor 2011, ZRRE kishte miratuar vlerat indikative për reduktimin e humbjeve në rrjetin shpërndarjes dhe vlerën indikative të mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit. Vendimi i ZRRE-së dhe Raportet Konsultative lidhur me këto vlera indikative janë publikuar në ueb-faqen e ZRRE-së.

Ky dokument ka për qëllim të caktojë vlerat e sakta të cilat do të përdoren për llogaritjen e Të Hyrave Maksimale të Lejuara dhe tarifave për Periudhën e ardhshme Rregullative.

2 Vlerat indikative

Pas konsultimit të rregullt me publikun, në mbledhjen e mbajtur më 29 dhjetor 2011, Bordi i ZRRE-së kishte miratuar vlerat indikative për reduktimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes si dhe vlerën indikative të mesatares së ponderuar të kostos së kapitalit. Qëllimi i këtij vendimi ishte reflektimi i vlerave të përfaqësuara që konsiderohen të arsyeshme për llogaritje të Të Hyrave Maksimale të Lejuara, në pajtim me konkluzionet dhe komentet e pranuar nga palët e interesit.

2.1 Vlera indikative për Mesataren e Ponderuar të Kostos së Kapitalit

Pas konsultimeve me publikun, Zyra e Rregullatorit për Energji kishte vendosur që vlera indikative e Mesatares së Ponderuar të Kostos së Kapitalit (nominale me 3% inflacion) të jetë 14.5% duke supozuar leverazh (gearing) në vlerë prej 50%.

2.2 Vlerat indikative për reduktimin e humbjeve

Pas konsultimeve me publikun, Zyra e Rregullatorit për Energji kishte vendosur që trajektorja indikative për reduktimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes të jetë si në vijim:

| Caqet indikative të reduktimit të humbjeve | |
|--|------|
| Vitet | % |
| 2012 | 3 |
| 2013 | 3 |
| 2014 | 3 |
| 2015 | 2.5 |
| 2016 | 2.5 |
| 2017 | 2.5 |
| Gjithsej | 16.5 |

3 Komentet e Këshilltarëve të Transakcionit

Në ndërkohë, më datë 24 janar 2012, ZRRE ka pranuar një shkresë nga Këshilltarët e Qeverisë për Transakcionin e KEDS-it lidhur me vlerat indikative të ZRRE-së. Në shkresën e tyre¹, e cila sipas Këshilltarëve të Transakcionit është hartuar me kërkesën e Ministrit për Zhvillim Ekonomik, Këshilltarët e Transakcionit deklarojnë se vlerat indikative të përcaktuara nga Rregullatori nuk janë të mjaftueshme për të siguruar investime në KEDS, në pajtim me Strategjinë e Energjisë të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. Për më tepër, Këshilltarët e Transakcionit kërkojnë që:

1. MPKK-ja nominale para taksës të mos jetë më e ulët se 16.5%;
2. Faktori i ndarjes së humbjeve të jetë 0%. Niveli i humbjeve të lejuara të caktohet në nivelin e realizuar në fund të periudhës së tranzicionit. Niveli i humbjeve të mos ndryshojë nga viti në vit. Në fund të periudhës rregullative, niveli i humbjeve të lejuara të reduktohet për 15% ($6 \times 2.5\%$) dhe ky nivel të mos zbritet për 5 vitet e periudhës së ardhshme rregullative. Në fund të periudhës së dytë rregullative, humbjet do të reduktoheshin edhe për 10% ($5 \times 2.0\%$).
3. Faktori i efijencës të caktohet në 0% për 6 vite në pajtim me kërkesën e Qeverisë së Kosovës për të garantuar punësim për 3 vitet e para.
4. Borxhi i keq të jetë 5% për 6 vite dhe 2.5% për periudhën e ardhshme rregullative.

Në shkresën e tyre Këshilltarët e Transakcionit poashtu kanë kërkuar edhe përcaktimin e disa parametrave të tjerë të cilat ZRRE i konsideron të pamundur për t'u vendosur pa shqyrtim të rregullt dhe të cilat nuk mund të përcaktohen për një periudhë aq të gjatë të kërkuar nga IFC.

4 Përcaktimi i vlerave përfundimtare

Pas shqyrtimit të komenteve të Këshilltarëve të Transakcionit, në mbledhjen e mbajtur më 6 shkurt 2012, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji ka vendosur që:

1. Mesatarja e Ponderuar e Kostos së Kapitalit të jetë 15% nominale (3% inflacion) për periudhën tranzitore dhe për shqyrtimin e ardhshëm periodik (1+5 vjet), me supozimin se leverazhi (gearing-u) është 50%.
2. Trajektorja e reduktimit të humbjeve në shpërndarje të fillojë nga vlera e realizuar në vitin 2011 dhe të reduktohet për 3% (pikë përqindjeje) në 3 vitet e para dhe për 2.5% (pikë përqindjeje) në 3 vitet vijuese. Faktori i ndarjes së humbjeve të jetë 0%.

¹ Shkresa e Këshilltarëve të Transakcionit është publikuar në ueb-faqen e ZRRE-së.

Përcaktimi i vlerave përfundimtare

3. Niveli i Borxhit të Keq të jetë 5% për 3 vitet e para dhe 4% për 3 vitet vijuese.
4. Faktori i efijencës të jetë 0% për 3 vitet e para dhe më së shumti 5% për vit për 3 vitet vijuese. ZRRE sugjeron që ta konsultojë publiku para vendosjes definitive për cakun për 3 vitet e fundit.

Bordi i ZRRE-së konsideron që vlerat e përcaktuara nga Rregullatori paraqesin lëvizje drejt kërkesave të Këshilltarëve të Transakcionit duke respektuar, në të njëjtën kohë, edhe vlerat indikative të vendosura më parë nga ZRRE.